



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. 2300 Prot.

13.50

Tiranë, më 17 / 07 /2023

KËRKESË

DREJTUAR:

ZONJËS LINDITA NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit

KËRKUES:

JO MË PAK SE 7 DEPUTETË – ANËTARË TË GRUPIT
PARLAMENTAR TË PARTISË DEMOKRATIKE

OBJEKTI:

- 1) Kërkesë për interpelancë urgjente me Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, z. Edi Rama.
- 2) Përfshirja e interpelancës si pikë e parë e rendit të ditës së seancës plenare të datës 20.07.2023.

BAZA LIGJORE:

Neni 7 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, si dhe neni 97 i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

E nderuar znj. Kryetare e Kuvendit,

Prej vitesh Shqipëria është përfshirë në një debat të gjerë politik dhe publik mbi një “zgjidhje” që Qeveria Shqiptare vendosi t’i japë problemit të mbetjeve në vend, duke nënshkruar 3 kontrata koncesioni/partneriteti publik privat me dy biznesmenë Klodian Zoton dhe Mirel Mërtirin, edhe pse këto të fundit nuk kishin asnjë eksperiencë në këtë fushë. Në më shumë se një rast, organet e drejtësisë kanë konstatuar se të tre procedurat e koncesionit/PPP janë kryer në shkelje të ligjit, duke i shkaktuar Buxhetit të Shtetit një dëm të konsiderueshëm financiar. Madje është fakt që edhe pse janë paguar miliona euro nga Buxheti i Shtetit, problem i mbetjeve në qarqet Elbasan, Fier dhe Tiranë nuk është zgjidhur ende.

Javën e shkuar Kuvendi u njoh me kërkesën për arrestimin e ish-Zëvendëskryeministrit dhe ish-Ministrit Arben Ahmetaj, ku gjithashtu konfirmohej fakti që procedurat ishin rrjedhojë e shkeljes së ligjit dhe se kompanitë e inceneratorëve kishin përfituar pagesa fiktive dhe kishin rritur kostot

- 1- Identifikimin e vendndodhjes së bashkëpunëtorit të tij më të afërt dhe dorëzimin e tij drejtësisë. Sot çdo qytetar shqiptar pyet Kryeministrin Edi Rama: Ku fshihet ish-Zëvendëskryeministri Arben Ahmetaj?
- 2- Paratë e Buxhetit të Shtetit që janë paguar për punë të pakryera apo për punime fiktive, a janë rikthyer në Buxhetin e Shtetit? Përsa kohë inceneratorët janë rrjedhojë e veprimeve korruptive dhe të paligjshme, pse vijohet me ekzekutimin e kontratave dhe me pagesat nga Buxheti i Shtetit për konpanitë në pronësi të tre personave në kërkim ndërkombëtar?

Mirëpo, Kryeministri i Shqipërisë jo vetëm nuk është alarmuar nga paligjshmëria dhe mënyra sesi Qeveria e tij dhe administrata publike ka vepruar në atë çështje, por duket se është frymëzuesi i gjithë kësaj paligjshmërie. Fillimisht Kryeministri Edi Rama sulmoi opozitën për denoncimin e aferës së inceneratorëve, më pas tentoi të manipulonte opinionin publik se ajo ishte një zgjidhje në interes të qytetarëve, më pas fshehu paligjshmërinë duke u shndërruar në fasadë e inceneratorëve së bashku me Grupin e tij Parlamentar, më pas mori përsipër të dilte në konkluzionin se procedurat kishin qenë të ligjshme dhe në fund iu shmang përgjegjësisë përmes sloganit se “përgjegjësia është individuale”. Padyshim që përgjegjësia penale është individuale, por përgjegjësia politike është kolektive, aq më shumë ku rezulton që në një aferë qeveritare është përfshirë gjysma e ministrive dhe një numër i konsiderueshëm zyrtarësh publikë.

Edhe pse tashmë rezulton e provuar që në këtë aferë me vlerë të paktën 430 milion euro, Buxhetit të Shtetit i është shkaktuar një dëm i konsiderueshëm financiar, nuk rezulton që institucionet shtetërore të kenë ndërmarrë veprime për të korrigjuar paligjshmërinë dhe për të shmangur dëmin financiar për Buxhetin e Shtetit. 3 pronarët e deklaruar të inceneratorëve janë persona të shpallur në kërkim ndërkombëtar, por edhe pse në arrati institucionet shtetërore vijnë të jenë financues të tyre, duke vijuar pagesat për punë të pakryera. Praktikisht, institucionet shtetërore përmes pagesave nga Buxheti i Shtetit po shërbejnë si financues të jetesës së tyre në arrati.

Deputetët e opozitës parlamentare janë thellësisht të shqetësuar për këtë fakt dhe për heshtjen dhe mosveprimin e të gjitha institucioneve shtetërore për këtë absurditet me pasojë financiare për Buxhetin e Shtetit. Në vlerësimin tonë, është detyrë e Kryeministrit të një vendi kandidat për në Bashkimin Europian që të analizojë me përgjegjshmëri këto fakte tronditëse, si dhe të mbajë qëndrim publik mbi punën e kryer nga institucionet shtetërore për të ndaluar paligjshmërinë, për të penguar financimin publik të arratisë së tre personave të shpallur në kërkim ndërkombëtar dhe për të rikthyer në Buxhetin e Shtetit të gjitha pagesat fiktive të kryera. Kryeministri Edi Rama ka detyrimin kushtetutes tu përgjigjet dy pyetjeve të mësipërme që sot bën cdo qytetar shqiptar.

Në këto kushte, në përputhje me nenin 97 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, ku parashikohet se: “*Një Kryetar grupi parlamentar ose 7 deputetë mund të kërkojë zhvillimin e një interpelance për çështje urgjente*”, me qëllim marrjen e një informacioni të plotë mbi masat e marra nga Kryeministri për frenimin e fenomeneve të tilla negative dhe rikthimin e ligjshmërisë lidhur me 3 procedurat koncesionare/PPP për inceneratorët,

KËRKOJMË:

Zhvillimin e një interpelance urgjente me Kryeministrin për të raportuar në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e institucioneve shtetërore lidhur me paligjshmërinë e konstatuar në 3 procedurat e koncesionit/PPP së inceneratorit të Elbasanit, Fierit dhe Tiranës, masat e marra për shlyerjen e dëmëve financiare që i janë shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe masat e marra për të ndaluar menjëherë pagesat që janë rrjedhojë e 3 kontratave të paligjshme dhe që rezultojnë se janë të prekuara nga fenomeni i korrupsionit masiv.

Kjo kërkesë e opozitës parlamentare, bazohet edhe në nenin 7 të Kushtetutës, ku sanksionohet parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Nën dritën e këtij parimi, merr përparësi funksioni i kontrollit parlamentar, i cili nënkupton të drejtën e pushtetit legjislativ për t'u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen për zbatimin e ligjeve nga organet e pushtetit publik, brenda kufijve të përcaktuar nga Kushtetuta, me qëllim marrjen e masave të domosdoshme për parandalimin e paligjshmërisë si dhe nxjerrjen e përgjegjësive, sipas rasteve konkrete. Të gjitha çështjet që përmbajnë në vetvete një interes publik përfshihen brenda funksionit të kontrollit parlamentar. Në këtë rast, mbrojtja e interesave financiare të shtetit dhe shmangia e paligjshmërive në veprimtarinë e pushtetit ekzekutiv, është një nga detyrat themelore të organeve publike të shtetit shqiptar. Për këtë arsye, deputetët kërkues e vlerësojnë të nevojshme zhvillimin e një interpelance urgjente me Kryeministrin.

Duke qenë se kjo çështje përbën shqetësim madhor dhe një çështje me natyrë urgjente për opozitën parlamentare, si dhe dhe në kushtet e një mungese tërësore të reagimit, veprimit apo sqarimit të rrethanave nga Kryeministri, në mbështetje të paragrafit 2 të nenit 97 të Rregullores së Kuvendit, ku parashikohet se: *“Interpelanca për çështje urgjente, si rregull, depozitohet në Kuvend jo më vonë se dita e hënë në orën 14.00 dhe ajo zhvillohet si pikë e parë e rendit të ditës në një nga seancat plenare të javës në vijim”*,

KËRKOJMË:

Përfshirjen e kësaj kërkesë për interpelancë urgjente me Kryeministrin në rendin e ditës të seancës së datës 20.07.2023.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DEPUTETËT:

EMËR MBIEMËR	NËNSHKRIM
--------------	-----------

1. Gazment	Banolli
2. Janina	Jubani
3. Lleri	Gjergji
4. Orjela	Meksiçaj ³
5. Bledar	Kollçati
6. Rani	Xhafa



7. Sluuts Cup, *Cup*
- 8) Letter Geskiedenis *Kostg*
9. Xistal Prais *Jesaja 23*
10. Yelidon Buzleti *Queda*
11. Kewelleur *Atay*
12. Saimit Tomelid *Queda*
13. Doshnor Sula *Queda*